Rruga e Arbërit

Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti I i Botimit. **Nr. 5.** **Shtator 2006** Çmimi: **30** lekë

Peshkopia, oazi i qetë në verilindje

"TIRANA TIMES STAFF"

PESHKOPI, 7 shtator – Vera është ende e nxehtë në Tiranë, përgjatë bregdetit dhe në qytete të tjera në vend. Por nuk ndjehet kaq shumë në Peshkopinë lindore, e mbrojtur nga mbulesa e gjelbërt në gjithë zonën atje. "Është një favor që e kemi krijuar vetë, e mbrojtur madje edhe në ditët më të vështira të pranverës 1997", thotë kryetari i bashkisë, Ilir Krosi.

Peshkopia është zhvilluar pak gjatë periudhës paskomuniste, pas vitit 1990. Si edhe në qytete të tjerë, shumë njerëz kanë shfrytëzuar mungesen e ligjit dhe kanë ndërtuar shtëpi të ndryshme apo krijuar objekte për bizneset e tyre. "Rreth 30 prej tyre u shkatërruan muajin e fundit dhe mbeturinat vazhdojnë të jenë e të shihen çdo ditë, diçka që natyrisht të ndot sytë".

Megjithatë, njerëzit në Peshkopi duket që ende u pëlqen ideja që jetojnë në komunitet. Kryetari i bashkisë thotë se ka shumë të interesuar për punët e ditës. Përfaqësues të lagjeve të qytetit mbledhin ankesat ose idetë e qytetarëve e ia kalojnë ato bashkisë. Ata marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e bashkisë.

Qytetarët e kanë mbrojtur mirë gjelbërimin në qytet. Mesatarisht ka 15 metra katrorë gjelbërim për çdo banor në këtë qytet. "Gjelbërimi është krenaria jonë", nuk e fsheh kryetari i bashkisë.

Kjo nuk është gjithçka nga ky qytet. Nëse qëndron disa ditë mund të mësosh shumë më tepër.

Ndoshta mund të jetë i vetmi qytet në këtë vend ku biznesmenet nuk i mbyllin produktet e tyre kur mbyllin dyqanin. Ata nuk kanë frikë se mund t'i vjedhë ndokush. Vjedhja është shumë e rrallë në këtë qytet. "Unë vetëm i mbuloj produketet, por nuk kam frikë se mund t'i vjedhë dikush", thotë Resmi Cera.

Gjatë gjysmës së parë të vitit nuk ka patur ndonje rast vjedhje, sipas zëdhënësit të policisë Aldo Puca. "Një fenomen i tillë është shumë i rrallë në këtë qytet", shton ai.

Në qytet nuk ka parkingje të mbyllura për vetura, që zakonisht qëndrojnë jashtë.

(Vijon në faqen 8)

Gazeta "Tirana Times", botim i Institutit të Studimeve Ndërkombëtare, që botohen në Tiranë, në numrin e datës 8 shtator ka botuar një shkrim për Peshkopinë. Gazeta botohet në gjuhën angleze dhe i drejtohet një opinioni anglishtfolës në vend, kryesisht institucioneve ndërkombëtare. Gazeta shërben edhe si një "guidë" për turistët e huaj, të cilët marrin një informacion të parë për Shqipërinë dhe shqiptarët, ngjarjet e ditës në vend, kulturën, trashgiminë kulturore, etj. Shpesh në këtë gazetë rekomandohen vende të vizitueshmë në vend, një prej të cilave është edhe Peshkopia. Për këtë arsye po japim për lexuesit të përkthyer shkrimin e Tirana Times.



Busti i Elez Isufit para godinës së bashkisë në Peshkopi

Atje ku ka lindur urtia dhe bukuria

Nga Viron KONA - Faqe 5

TE NJOHIM BIZNESMENET E DIBRES

Musa Rriçku, njeriu bujar me zemër të madhe



Po të pyesësh në Laprakë për Musa Rrickun, të gjithë e njohin. Edhe fëmijët dhe pleqtë. Ai është një biznesmen dibran, që ka krijuar emër të mirë për veten dhe Dibrën në metropolin shqiptar. ***(Faqe 3)***

Kryesia e LID mblidhet për të zgjedhur strukturat drejtuese të shoqatës

Prof. Dr. Nuri Abdiu zgjidhet kryetar i shoqatës LID

FAQE 2

"Një botim me vlera shkencore për Dibrën"

FAQE 2

Dibranët i rikthehen traditës

FAQE 5

HISTORI

Mbas ardhjes së Princ Vidit në Durrës

Vazhdon botimi i shënimeve të **Ismail Strazimirit**

FAQE 6

PORTRET

Elez Sadik Koçi, një jetë në shërbim të gjuhës shqipe dhe atdheut

FAQE 7

"Sopata" po zhduk pyjet

Energjia, po punohet për një dimër me drita

FAQE 7

Adresa e redaksisë: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë. Tel.068 31 19 232. E-mail: Lid_gazeta@yahoo.com.

Kryesia e LID mblidhet për të zgjedhur strukturat drejtuese të shoqatës

Prof. Dr. Nuri Abdiu zgjidhet kryetar i shoqatës

Nënkryetar të shoqatës u zgjodhën znj. Edlira Haxhiymeri, z. Rakip Suli dhe z. Musa Rriçku. Sekretar Hajri Mandri

Në kuadrin e organizimit të shoqatës "LID", ditën e shtunë, datë 16 shtator 2006, u mblodh kryesia e shoqatës. Kjo kryesi, e autorizuar nga Asambleja e Përgjithshme e muajit Qershor 2006, diskutoi dhe vendosi për kryetarin e shoqatës, nënkryetarët e saj si dhe mënyrat se si do të vazhdojë organizimi i mëtejshëm i departamenteve të shoqatës në veçanti dhe shoqatës në tërësi. Po ashtu, u diskutua edhe për disa pika të programit e statutit, të cilat duhen parë në kuadrin e funksionimit sa më të mirë të shoqatës.

Të pranishmit në mbledhje, Nuri Abdiu, Hasan Çipuri, Hasan Lleshi, Hajdi Mandri, Lavderime Abazi, Musa Ricku, Bashkim Lleshi, Abaz Deda, Sali Shira, Shaqir Skarra, Bujar Karoshi, Shaban Bitri, Rakip Suli, diskutuan për kandidaturat për kryetarin dhe në mënyrë unanime vendosën që kryetar të jetë z. Nuri Abdiu. Ndërsa nënkryetarë u konfirmuan znj. Edlira Haxhiymeri, z. Musa Rriçku dhe z. Rakip Suli. Si sekretar do të vazhdojë z. Hajri Mandri.

Në fjalën e tij, kryetari i sapozgjedhur z. Nuri Abdiu, theksoi se shoqata nën drejtimin e tij nuk mund të bëjë asgjë pa ndihmën e gjithë anëtarësisë dhe në veçanti të kryesisë. Ai theksoi nevojën e zgjerimit të anëtarësisë, mënyrat dhe rrugët si duhet bërë ky zgjerim. Gjithashtu, ai tërhoqi vërejtjen për disa anëtarë të kryesisë të zgjedhur nga asambleja, të cilën nuk janë aktiv në mbledhjet e kryesisë. Po ashtu, z. Abdiu shtoi nevojën e disa korrigjimeve në statut, që shoqata të jetë më funksionale. Ai propozoi që në mbledhjen e ardhshme të kryesisë, të diskutohet për një projekt aktivitetesh të shoqatës gjatë vitit të ardhshëm.

Të tjerë diskutantë folën për nevojën e shtimit të radhëve të shoqatës. Z. Hasan Çipuri, Bashkim Lleshi, Abaz Deda, Hasan Lleshi, etj., folën për probleme të organizimit të LID, probleme të funksionimit, abonimit dhe shpërndarjes së gazetës, disa ndryshime në status si dhe mënyrat e ndryshme se si shoqata mund të jetë më e ndjeshme mes komunitetit dibran. Në këtë kontekst u diskutua edhe për Rrugën e Arbërit, mënyrat e ndryshme se si kjo çështje mund të kthehet në një prioritet për institucionet shtetërore.

Kush është Prof. dr. Nuri Abdiu?



Prof. Dr. Nuri Abdiu ka lindur në Sohodoll të rrethit të Dibrës më 1 shkurt 1930. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen pedagogjike në qytetin e Peshkopisë, kurse studimet e larta për psikologji-pedagogji i kreu me rezultate të shkëlqyera në Fakultetin Pedagogjik të Institutit Pedagogjik "Lenin" të Moskës, më 1958. Po në këtë vit u emërua pedagog i psikologjisë dhe pedagogjisë në Institutin Pedagogjik të Shkodrës (nga 1991 në vijim Universiteti "Luigj Gurakuqi"), në të cilin punoi deri në shkurt 1993, kur e nxorën në "pension" për motive politike.

N. Abdiu gjatë veprimtarisë së tij 36-vjeçare në këtë institucion është dalluar: për një veprimtari të gjerë e të shumanshme pedagogjike, mësimore-edukative, shkencore dhe shoqërore; për ndihmesën e shquar që ka dhënë në ngritjen e cilësisë së shkollës së lartë, në edukimin atdhetar dhe përgatitjen shkencore dhe pedagogjike të mësuesve të rinj. Për këto, nga viti 1962 gjer më 1974, ka kryer detyrën e zv.drejtorit për anën mësimore dhe shkencore, njëherazi dhe të kryetarit të Komisionit të Psikologji-Pedagogjisë dhe, me krijimin e Katedrës së Psikologji-Pedagogjisë më 1981 është emëruar shef i kësaj Katedre dhe i Degës së Mësuesisë për ciklin e ulët (gjer më 1990).

Gjatë kësaj kohe, Nuri Abdiu ka mbajtur leksione jo vetëm në Institutin dhe Universitetin e Shkodrës, por nga 1981-1990 edhe në kursin Pasuniversitar të Psikologji-Pedagogjisë pranë Fakultetit Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës.

Krahas punës mësimore-edukative dhe asaj drejtuese, Nuri Abdiu është marrë në mënyrë sistematike dhe me punë kërkimore-shkencore dhe botuese. Është bashkautor i shtatë teksteve, tre teksteve të psikologjisë për shkollat e larta (1971, 1981, 1984), i dy teksteve të psikologjisë për shkollat e mesme pedagogjike (1985, 1986), i një përmbledhjeje për seminarët e psikologjisë (1973) dhe i manualit "Psikologjia e Personalitetit" për kursin pasuniversitar të Psikologjisë dhe Pedagogjisë të Universitetit të Tiranës (1988).

Lista e punimeve shkencore, studimeve, kumtimeve shkencore dhe artikujve të tij, arrin në mbi 150 zëra. Prej tyre, 66 punime janë botuar në organe e përmbledhje shkencore dhe 39 kumtesa të mbajtura në sesione të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, si në Kongresin e VI Europian të Psikologjisë (Romë, 1999), në Prishtinë, etj. Nga këto kumtesa, 14 janë të botuara. Veç kësaj, Nuri Abdiu ka meritën se është hartuesi i parë i Bibliografisë së punimeve shqiptare në lëmin e psikologjisë (botuar më 1985).

Vepra e tij kryesore që përbën një kontribut të veçantë në përgjithësimin e përvojës sonë kombëtare në fushën e mendimit psikologjik shqiptar është studimi i tij voluminoz "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar (gjer më 1939)" (botuar më 2002), që është rezultat i hulumtimeve, meditimeve, përgjithësimeve dhe botimeve monografike me përmasa më të vogla gjatë një periudhe 20-vjeçare. Gjithashtu, ka gati për botim edhe një tekst për historinë e psikologjisë shqiptare, monografinë "Psikologjia e Hasan Tahsinin", etj.

Për të gjitha këto, N. Abdiu, më 1973, ka marrë titullin shkencor "Docent", më 1991 gradën "Doktor i shkencave" dhe më 1999 titullin shkencor "Profesor".

Prof. Dr. Nuri Abdiu është nënkryetar i shoqatës mbarëshqiptare të psikologëve dhe konsulent botues (Editorial consultant) në revistën shkencore "European Psychologyst" që botohet në Hamburg (Gjermani). Është dekoruar me medaljen e "Punës" më 1968, me urdhrin "Naim Frashëri" të klasit të parë më 1980, dhe me titujt e lartë "Mësues i merituar" më 1987 dhe "Mësues i popullit" më 1989.


Vazhdon të mbajë leksione të psikologjisë si pedagog i jashtëm në Universitetin e Tiranës (nga 1988) dhe në Universitetin e Tetovës (nga 1996). Aktualisht drejton Departamentin e Psikologjisë në Universitetin Jopublik "UFO".

"Një botim me vlera shkencore për Dibrën"

Nga Prof. Dr. VALTER SHTYLLA

Kjo monografi, është një botim me vlera shkencore e historike jo vetëm për trevën e Dibrës, për të cilën bëhet fjalë në të, por edhe për të gjithë historinë e zhvillimit të rrjetit rrugor të Shqipërisë.

Treva dibrane, me një histori të pasur dhe me ndërtime rrugore të shpërndara në të gjithë hapësirën e saj e meriton një botim të tillë, aq më tepër, të realizuar nga një studiues vendas, tashmë i pjekur dhe i formuar si historian e si gjurmues i apasionuar, i cili i ka kushtuar shumë vite të jetës së tij gjurmimit dhe studimit të vlerave kulturore të trevës ku ka lindur. Eshtë i nderuar dhe i respektuar ai studiues që me pasion e dashuri i bën të njohur popullit të zonës së tij, ato vlera që ai ka krijuar gjatë shekujve, duke e bërë atë, në të njëjtën kohë, më të ndërgjegjshëm për aftësitë krijuese.



Autori i këtij botimi shkencor ka meritën se ka ndjerë detyrimin e tij moral e qytetar, që dijet e fituara me punën e tij pasionante, t'i hedhë në letër, i cili përbën dhe një angazhim serioz për emrin e tij.

Monografia shkencore "Rrugët e vjetra të Dibrës" paraqet një material aq të bollshëm dhe autori tashmë i ka të gjitha mundësitë, që pjesë të kësaj monografie dhe materiale të tjera, që autorit nuk i mungojnë, t'i paraqesë në një botim të ri mbi "Historinë e krahinës së Dibrës".

Z. Kaca, në veprën e tij është mbështetur në gjurmimet shumëvjeçare në terren, në burimet bibliografike-historike dhe në burime e të dhëna direkte nga goja e popullit, të trashëguara nga ky i fundit brez pas brezi. Ai e ka ndërtuar veprën e tij në 11 kapituj, duke nënvizuar tre akset kryesore: rrugën e Drinit të Zi, rrugën Durrës-Tiranë, rrugën Dibër-Elbasan, si dhe rrugët e Grykës së Radikës, duke kaluar më tej në rrugë të tjera të rëndësishme dhe së fundi në ato të dorës së dytë.

Tre akset më të rëndësishme, të cilët autori i thekson me të drejtë, janë degë dhe lidhje direkte me aksin antik transballkanik, Via Egnatia, rrugë mjaft e rëndësishme, e cila lidhte perëndimin me lindjen. Gjatë përshkrimit të aksit rrugor të Dibrës, autori është nisur nga karakteri kronologjik me analiza arkeologjike, të kulturës materiale dhe mbështetur në kulturë, me burime bibliografike të autorëve dhe udhëtarëve të huaj të antikitetit e të mesjetës.

Nga pikëpamja metodike, për një autor, specialist i historisë, jo të profilit inxhinierik, mendoj se boshti i trajtimit të monografisë është gjetur drejt. Në të gjitha rastet, kuadri arkeologjiko-historik që mbështet akset rrugore është realizuar në masën e nevojshme, bile në ndonjë rast, ndofta edhe me tepricë...

I uroj z. Kaca një mesazh suksesi për këtë botim të vlefshëm duke nënvizuar gjithashtu se do të ishte një nder për mua, që rradhë të recenzës sime të përbënin dhe parathënien e këtij botimi interesant për kulturën tonë, duke nënkuptuar këtu dhe nënshkrimin tim.

Gjuha dhe shprehjet e autorit janë të rrjedhshme dhe të kuptueshme.

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: **RAKIP SULI**
Kryeredaktor: **SHAQIR SKARRA**
Redaksia: **Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Bujar Karoshi, Dukagjin Hata, Hasan Leka, Mirvet Lala**
ADRESA E GAZETËS: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë.
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179.
Email: lid_gazeta@yahoo.com

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" ka dhe numrin e saj të llogarisë në **PROCREDIT BANK**
Në lek 13-661344-0001 . Euro 13-661344-0102 . USD 13-661344-0203

NJOFTIM

Gazeta "Rruga e Arbërit", njofton gjithë lexuesit dhe bashkëpunëtorët, se numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit. Për abonimet dhe shpërndarjen e gazetës në adresa tuaj, duhet të telefononi në numrin e telefonit: **(04) 357 179,** ose të na shkruani në **Email: lid_gazeta@yahoo.com**

Reklamoni biznesin tuaj!

Gazeta "Rruga e Arbërit" vë në dispozicion hapsirat e nevojshme për reklamën tuaj!
Tel.**068 31 19 232.**
Tel: **(04) 357 179.**
Email: **lid_gazeta@yahoo.com**

TË NJOHIM BIZNESMENËT E DIBRËS

Musa Rriçku, njeriu bujar me zemër të madhe

Po të pyesësh në Laprakë për Musa Rrickun, të gjithë e njohin. Edhe fëmijët dhe pleqtë. Ai është një biznesmen dibran, që ka krijuar emër të mirë për veten dhe Dibrën në metropolin shqiptar. E megjithatë, vetë Musai është modest, shumë modest. Në fillim e nisi me tregti ambulante. Edhe vetë nuk mund ta imagjinonte se do të arrinte një ditë këtu ku është sot. Në vitin 1992, vit ky që Musai në sajë të reformës në ushtri, largohet nga puna, i ngjitet karvanit të madh të emigrantëve që kalonin në Greqi për një jetesë më të mirë. Ai nuk mund ta linte edhe këtë shans pa provuar.Vetëm një vit qëndroi në tokën helene dhe kthehet në vendlindje por me një qëllim në vetvete. “Do të futem në ekonominë e tregut”, - u thoshte shokëve dhe, kështu bëri. Nuk i mungonte guximi dhe inisiativa, ndaj në vitin 1994, merr liçencë për tregtimin e artikujve ushqimor dhe detergjent të ndryshëm. Shumë shpejt aktiviteti zgjerohet dhe Musai punëson disa veta nga qyteti i Peshkopisë. Në vitin 1997, biznesi i Musa Rriçku ndryshon status, tani merr liçencë si person juridik me qendër në Peshkopia, e cila vazhdon aktivitetin edhe sot. Viti 1997 ishte i vështirë për të gjithë, sidomos për tregtarët, por është fakt se dyqanet që ishin në pronësi të Musa Rriçkut nuk u mbyllën asnjë ditë të vetme. Ishin pikërisht këto dyqane që furnizuan qytetin e Peshkopisë me bukë dhe ushqime. Musai nuk e ndali asnjë ditë udhëtimin drejt Tiranës për furnizim, megjithëse këto udhëtime ishin të vështira. Aktivitetin Musai dalngadalë filloi ta zgjerojë. Musa Rriçku hap një dyqan tjetër në metropolin shqiptar, përsëri me artikujt ushqimor dhe detergjent të ndryshëm, ku konkuroi ndershmërisht me cilësi dhe çmime të leverdisshme për qytetarët. Kjo i dha më shumë emër dhe popullaritet. Vetëm para pak ditësh, në qendër të Laprakës, pikërisht aty ku lartojnë ndërtesat e pallateve të bllokut “Gintash”, ka ngritur një market modern. Një reklamë e madhe që ndricon në krahun e “Rrugës së Durrësit:, por dhe në krahun tjetër nga pallatet, fton klientët të futen në këto ambiente. Është i pari i këtij lloji, jo vetëm në Laprakë, por themi me bindje se ndoshta janë të paktë dhe në kryeqytetin shqiptar markete të tilla. Aty gjenden mbi 6000 artikuj të ndryshëm. Kjo ka qënë një ëndërr e hershme e Musait. Ndërtimi i një supermarketi, ku qytetarët të gjejnë gjithcka ju duhet në jetën e përditshme dhe të ndjehen si në dyqanin e tyre. Shumë shpejt, pas Tiranës, një market të tillë Musai mendon që ta ngrejë në qytetin e Peshkopisë. Ai konkuron me artikuj ushqimor jo vetëm në Tiranë dhe Peshkopi, por edhe në shumë rrethe të vendit. Kjo ka ardhur si rezultat kooperimi që po bën me kompani serioze brenda dhe jashtë vendit si ajo “Gudalat”. Por jo vetëm kaq. Musai sot bashkëpunon edhe me mjaft shoqëri turistike nëpër botë. Si njeri me vullnet dhe kurajo, Musa Rriçku pretendon se në një të ardhme të shpejtë, aktivitetin privat do ta zgjerojë. Tashmë ai i njeh mirë rregullat e lojës në ekonominë e tregut të lirë.



NDRYSHE NGA TË GJITHË

Flitet në popull ende, se të parët e Musa Rriçkut, shkrinë pasurinë për të shpëtuar fshatin nga djegiet dhe barbarizmat serbe. Fakt është, se në Limjan, nuk ka ekzistuar asnjëherë ndonjë han që të bujtnin udhëtarët e shumtë që kalonin kësaj udhe. Këtu, jo vetëm teqja hapte derën për udhëtarët, por dhe Limjani priste dhe përcillte udhëtarë dhe mysafirë në çdo orë, ditë apo natë qoftë. Fundja geni është gen, dhe themi me bindje se Musa Rriçku ka përfituar shumë nga të parët e tij. E kush ka trokitur në derën e tij dhe ka dalë i zhgënjyer? Jo vetëm në Dibër, por dhe në Tiranë, Musain e njohin për humanizmin që tregon.

“- Njeriut duhet me ia zgjat dorën në raste të tilla, - thotë Musai. Fundja, jemi shqiptar dhe nuk duhet të presim të na ndihmojnë të huajt. Ne duhet me ndihmue njëri-tjetrin”. Por jo vetëm kaq. Musai ka sponsorizuar botime të shumta që flasin për kulturën dhe historinë e Dibrës, aktivitete kulturore dhe sportive si dhe ka dhënë kontribut financiar në disa objekte kulti. Janë pikërisht këto, që e bëjnë Musa Rriçkun të njohur si njeri human!

JETA

Musai lindi në ditën e parë të vitit 1956 në Limjan, fshat ku para treqind e pesëdhjet vitesh, ishte ngritur teqja që ka bërë emër vite me radhë, jo vetëm në Limjan, por dhe jashtë saj. Shkollën fillore dhe tetëvjeçare i mbaroi në fshatin e lindjes. Ende e kujton me respekt mësuesin e parë, Pijazit Shehu. Në vitet 1970-1974 mbaron shkollën Pedagogjike në Peshkopi me nota mjaft të mira. Menjëherë sapo mbaron shkollën, fillon punën si mësues në Lurë, saktësisht në Lejthizë, një zonë kjo e thellë malore. Qëndron aty për rreth tre vjet. Më pas shkëputet nga arsimi, për të vazhduar studimet e larta në shkollën e ministrisë së punëve të brendshme. Pas mbarimit të studimeve, fillon punë si oficer kundërzbulimi në njësitë ushtarake Burrel, Dibër, Laç. Qëndroi në ushtri deri në vitin 1992, vit në të cilin filluan reformat e mëdha në ushtri. Në vitin 1982 martohet me Hasie Devën, një vajzë intelektuale nga Muhurri. Ka tre djem: Klodianin, Erjonin dhe Nimetin. Klodiani është i martuar. Ai së bashku me vëllanë tjetër, Erjonin, vazhdojnë fakultetin juridik, ndërsa Nimeti është maturant në kolegjin ”Turgut Ozal”. Tre emrat e djemve i kanë dhënë edhe emrin supermarketit në Laprakë: “KEN”.






Atje ku ka lindur urtia dhe bukuria

Mbresa nga një udhëtim i shkurtër në Dibër

Nga Viron KONA

Para pak javësh, në Lurë u festua festa e Shën Gjergjit. Kjo festë mblodhi pranë bukurive të Lurës shumë njerëz. Të ardhur nga Tirana, Peshkopia dhe fshatrat përreth, festa, tani e kthyer në një ritual vjetor, u kalua gëzueshëm. Por shumë te tjerë në këtë festë nuk morën pjesë. Për një arsye shumë të thjeshtë, por tragjike për kohën që jetojmë: Një rrugë! Një rrugë për Lurën e mrekullive!

Por, për shumë veta që e vizitojnë Lurën tani dhe e kanë vizituar edhe shumë vite më para, Lura të zhgënjen. Por për të na rikujtuar Lurën e mrekullive, na vjen në ndihmë një shkrimtar nga Vlora, i cili e ka vizituar Parkun Kombwtar tw Lurws para 21 vitesh dhe, na sjell në kujtesë mrekullitë e saj. Për ta rikujtuar Lurën ashtu siç ka qënë, me dëshirën e mirë të riparojmë ç'të mundemi, në fillim me ndërtimin e një rruge, po botojmë reportazhin e shkrimtarit Viron Kona.



Në mëngjesin e 25 korrikut 1985 u nisëm drejt qytetit të Peshkopisë. Gjatë rrugës pyes për etimologjinë e emrit Peshkopi. Dikush nga shokët e mi thotë se ky emër vjen nga togfjalëshi: pesë shtëpi, një tjetër e shpjegon këtë me emrin Peshkopatë. Në këto biseda të shkurtra përmendim Dibrën si trevë të lashtë e banuar nga fisi ilir i penestëve, zëmë në gojë kalatë e lashta iliro - arbërore, nëntë malet e Dibrës, Korabin madhështor dhe mitologjik, që është dhe mali më i lartë i Shqipërisë (2751 metra), Drinin e Zi, që rrjedhë nga liqeni i Ohrit dhe kalon edhe nëpër Dibër. Drini i Zi është lumi më i gjatë i vendit, (285 kilometra); flasim për periudhën e Skënderbeut, mbështetjen e madhe që ai kishte në Dibër, folklorin e pasur të zonës, pasuritë e shumta minerale, florën dhe faunën e pasur... E, mbi të gjitha flasim për dibranët, njerëzit e guximshëm dhe të besës, punëtorë, bujarë e mikpritës.

Kështu duke biseduar mbërrijmë në qytetin e Peshkopisë. Një shëtitore na tërheq vëmendjen me hijeshinë dhe bukurinë e saj. Ajo e përshkon qytetin tejpërtej. Në dimër zbardhë nga dëbora, kurse në verë kundërmon nga era e këndshme dhe e ëmbël e blinve, që tek flladiten hijshëm, duket sikur nderojnë kokë ulur kalimtarët dhe banorët e qytetit. Është një rrugë e përmendur shpesh nga gazetarët dhe nga ata që e kanë vizituar Peshkopinë, por në biseda, edhe banorëve vendas u pëlqen ta përmendin rrugën e tyre të bukur, e cila për shkak të drurëve të rrallë zbukurues, ka nxitur mjaft njerëz që t'u vënë emrat fëmijëve të tyre: Erëblin, Erëblina.

"DËBORA ËSHTË E ZEZË"

Ka ngjarje në jetë që mbeten të ngulitura thellë në kujtesë, në mendjet dhe në përfytyrimet e njerëzve për shkak të rëndësisë apo pasojave që sjellin. Të tilla ishin dhe ngjarjet e dimrit (janar-shkurt) të vitit 1985, ku dimri si një kafshë e egër këputi vargonjtë dhe u vërsul me tërbim mbi Dibrën dhe njerëzit e saj. Ishte një nga ata dimra që transmetohen dhe shpërndajnë jehonën e tyre cep më cep vendit dhe mbeten gjatë në bisedat dhe kujtesën njerëzve: "Të kujtohet dimri i vitit 1985?", "Kështu ndodhi në dimrin e vitit 1985", dhe, në përfytyrimin e banorëve dibranë shfaqen ato ditë e net tepër të bardha nga ngjyra, por të zeza nga dhembjet që shkaktuan. Aq të thella ishin dhembjet dhe kujtimet e hidhura, saqë zunë vend në tregime dhe legjenda. Për të nxjerrë shokun e tyre nga gremina e thellë, ku e kishte vërvitur orteku, mbi 60 malësore dibranë, të zënë dorë më dorë, formuan një zinxhirë të fortë si çeliku dhe e nxorën bashkëfshatarin e tyre nga humnera që e priste gojë hapur ta gëlltiste nga çasti në çast. E nxorën në heshtje, pa iu trembur gërhitjeve së orteqeve përbindësha, që në ato çaste dremitnin, por që befas mund të zgjoheshin të egërsuar qoftë edhe nga tingulli i zërit të një njeriu të vetëm."Dëbora është e zezë", - thoshte Anaksagora dhe, kur shprehej kështu, ai me siguri kishte parasysh të tilla dimra të përbindshëm.

ODA ASHT E VOGËL, POR ZEMRA ASHT E MADHE

Shfaqim dëshirën që, krahas punës për të cilën kemi ardhur, të bëjmë edhe një shëtitje në Lurë. Por, shefi ynë, një burrë i rreptë, hijerëndë dhe që s'i qesh kurrë buza, nuk pranon: " - Tjetër program kemi. Pastaj, ç'e kini me kaq merak vajtjen në ato liqene akullnajorë, sikur do takoni atje të bukurën e Dheut ?!" Por ne ia përsërisim gati me lutje kërkesën tonë dhe, më në fund ai pranon. Nisim gjithë qejf rrugën për në Lurën e përmendur aq shumë në librat e shkollës, nëpër gazeta dhe revista, veçanërisht, për shtatë liqenet e saj të mrekullueshëm. Makina ecën ngadalë, duke përballuar me vështirësi të përpjetat dhe kthesat e shumta. Rruga gjarpëron mes kodrash dhe luginash. Ngado që të hedhësh sytë sheh gjurmët e punës, sheh livadhe, kullota, vreshta. Blegërimat e bagëtive gjallërojnë mjedisin dhe tingujt e zileve të tyre sikur krijojnë një variacion që përzihet me flladin e freskët të malit.

Në Grykë – Nokë, del përpara makinës një burrë rreth të dyzetave, i cili, duke njohur Tosunin, që është një nga kuadrot e rrethit, (atë ditë edhe shoqëruesi ynë), na fton çiltërsisht dhe me buzë në gaz për një vizitë në shtëpinë e tij: "-Ja, atje, tek ajo ara e madhe. Hajdeni të pini nga një ujë të ftohtë". Ftesa sinqertë e malësorit zemërbardhë nuk pranon kundërshtim…Zbresim nga makina dhe nuk ngopemi me ajrin e freskët dhe të pastër që vjen nga aromat e luleve dhe të pemëve që mbulojnë hapësirën përreth. Fshatari na heq udhën drejt shtëpisë së tij, një shtëpi e zhytur në jeshillëkun e hardhive të rrushit që harlisen, e rrethuar me pemë frutore: mollë, dardhë, kumbulla, pjeshkë, qershi, arra. Një malësor mbi 75 vjeçar, i gjatë, i thatë dhe fytyrëqeshur, na shtrëngon duart. Pranë tij nusja e shtëpisë, një grua e re, me flokët e mbledhur prapa, që i zbulojnë një fytyrë të bukur dhe të pastër, që bën xheloze edhe vetë bukurinë. Dy fëmijë të vegjël, na shohin buzagaz, çuçurisin vesh më vesh dhe qeshin mes tyre. Ulemi në vendin e caktuar për miqtë. Zonja e shtëpisë, sjellë tabakanë ku shkumëzojnë gotat me dhallë dhe, në pjata të vogla sallatorë të qëruar dhe kripë që na shijojnë dhe na sjellin zemrën ne vend me shijen dhe freskinë e tyre. Nisim të bisedojmë, teksa plaku dhe të gjithë të zotët e shtëpisë, me një ndjenjë preokupimi, kujdesen që ne të ndihemi sa më lirshëm, të shpimë këmbët si në shtëpitë tona, të mos druhemi:"-Oda asht e vogël, por zemra asht e madhe". Plaku flet rrallë, po kur e nxjerrë fjalën, duket sikur ngre një gurë të rëndë nga vendi dhe e vendosë në vendin e vet. Kur mëson se jemi nga rrethe të ndryshme të vendit, plaku thotë:"-Paskam miq nga e gjithë Shqipëria sot" dhe, befas, ai ngrihet dhe shfaq dëshirën që të na i bëj vet kafet. Dhe, ndërsa xhezvja e kafes zien, plaku i moçëm nis e këndon me zë të ulët, me një ndjenjë gëzimi për miqtë që i kanë ardhuri. Mbaj vesh fjalët e këngës:

Me gjoks flakën ia shuajmë topit
Jemi gjaku i Kastriotit
Le e rrit' në kull' t'barotit

Ashtu, gjithë gaz, na i sjellë kafet dhe ndjek me vëmendje fjalët tona të urimit dhe bisedat për jetën dhe bukurinë e vendit.

-A doni më kafe? - pyet ai pakëz më vonë.

Ne shohim njëri – tjetrin.

-Po, unë e desha edhe një kafe. - Shefi më sheh me vërejtje: "-Dashke të na mbash këtu. Pastaj, ç`është kjo dëshirë e pakuptimtë?!" - sikur më thotë vështrimi i tij.

Edhe shokët e tjerë më shohin me habi. Plaku ngrihet përsëri dhe mërmërima e këngës së tij sikur bëhet më e fortë. Dhe, teksa kafja zien në xhezve, u shpjegoja shokëve të mi se kur miku kërkon kafen e dytë, i tregon të zotit të shtëpisë se i ka shkuar në shtëpi me gjithë zemër, me të dyja këmbët.

-Si ia bëni për ujë? - pyeti njëri prej shokëve të mi.

-Kjo zonë nuk ka pasur ujë, - nis e përgjigjet djali i shtëpisë, - shkëmbi çahej nga thatësira, as pula s'kishte ku ta pinte një pikëz ujë. - Pastaj, duke hedhur vështrimin nga dritarja, na fton të shikojmë tej, disi larg një kanal të madh, i cili duke gurgulluar e shkumëzuar, përshkon zonën fushore dhe kodrinore. Ishte një kanal vaditës. Dhe. teksa ne ndjekim me sy vijën që përshkon kanali, e merr fjalën plaku dhe thotë me krenari se, ai kanal 17 kilometra i gjatë, (nga Fushë - Alia e deri në zonën e Kastriotit), është hapur me aksion brenda një…dite. Eh, atëherë drejtonte këtu një njeri që i njihte mirë hallet e Dibrës, një dibran që i thërrisnin ndryshe:"Njeriu i aksioneve". Sulë Baholli e quanin.

Bëmë mirë, shumë mirë që vizituam Lurën dhe ata liqene. Eh, janë me të vërtetë të mahnitshëm! Me siguri, atje është vendlindja e të Bukurës së Dheut"

KUR MA KTHEVE SHPINËN, VERA M'U BA DIMËN

Përpara nesh shfaqet Lura, me fshatrat e saj të vendosur në luginën e rrethuar nga kodrat e gjelbëruara. Nëpër qiellin e pastër luajnë tufa zogjsh, ndërsa tej larg në majat e maleve zbardhin kapuçat e dëborës. Një banesë e këndshme turistike mes ahesh e pishash, na hap derën dhe ne gjejmë përsëri mikpritjen dibrane. Befasohem kur takoj aty pedagogun dhe profesorin e mirënjohur të Universitetit të Tiranës, gjeografin Vasil Trojani, që, siç na shpjegon, ka ardhur për të bërë një studim për orteqet. Bëjmë një fotografi, dhe bashkëbisedojmë.

-Kam disa ditë që kam ardhur këtu, - thotë ai dhe vijon: - është vend i përshtatshëm për të studiuar orteqet. - Hesht një çast pastaj shton: - Orteqet kanë forcë të madhe shkatërrimtare, ndoshta jo më pak se tërmetet dhe përmbytjet. Në këtë zonë, në Krej - Lurë hasen orteqe në formën e pllakës, të cilët janë dhe më të rrezikshmit. - Më pas, ai shpjegon se veç Alpeve të Shqipërisë, edhe këtu në Lurë gjenden cirqet akullnajorë (në formë amfiteatri) të cilët janë të formuara nga akullnaja të dikurshme...

Teksa shokët e mi qetësohen dhe flladet frynin nëpër halat e pishave, bashkë me një lurjan, nisim të shëtisnim nëpër pyll."- Dibranët, - thotë ai, - janë popull autokton, gjë që vërtetohet nga zbulimet arkeologjike dhe studimet historike. Në kohën e pushtimit turk, në këto zona vepronte "Ligji i Maleve", por edhe "Kanuni i Skënderbeut". Dibranët kanë qenë model i qytetërimit, një popull që ka mbijetuar në gëzime e fatkeqësi të lidhur ngushtë si nëntë malet e këtij vendi. Këtu ka një folklor mjaft të pasur, ku dallohen këngët, rritet, larmia e kostumeve, dinamika e valleve, instrumentet popullore..

Nëpërmjet fjalëve të tij mësoj se sa i fortë ka qenë zakoni i besës, i nderimit dhe respektit për mikun. Një banor i këtyre anëve vrau të birin, sepse, kur i biri, sipas zakonit po përcillte një mik deri sa të dilte nga kufijtë e fshatit, e vrau për t'i marrë kalin e tij të bukur.

-"Unë që të linda, unë do të vrasë, sepse ti shkele mbi besën e malësorit", - i tha babai dibran të birit dhe krisma e pushkës së tij përshkoi malet dhe luginat. Tek meditoj për

Natyra çelet, hapet si një gonxhe dhe atje tej shndrit liqeni i luleve, sinonimi më i goditur i bukurisë. Te ky liqen dhe tek vëllezërit e tij të mrekullueshëm, vijnë dhe shihen në pasqyrë çdo ditë - dielli dhe çdo natë - yjet.

këto zakone, jehona e një kënge me lahutë, vjen papritur dhe më përkëdhel veshët. Një grup djemsh i këndojnë dashurisë, ku dalloj disa vargje që më mbeten në mendje:

Kur ma ktheve shpinën
Vera m'u ba dimën.

Një copë herë ndjek këngën e djemve lurjanë, pastaj pylli më rrëmben në gjirin e tij të mistershëm…

MOS JUA BËNI QEJFIN DERI NË FUND FËMIJËVE, SE PËRKËDHELEN

Udhëtojmë përmes "Parkut Kombëtar" të Lurës. Rruga dredhon përsëri përmes pishave të zeza dhe drurëve të ahut dhe shkon drejt lartësisë 1500 - 1700 metra mbi nivelin e detit. Era që fryn dhe bukuria e vendit na krijojnë kënaqësi dhe ne i gëzohemi si fëmijë atij peizazhi me bukuri të pasosur.... Befas, përpara syve tanë shfaqet një liqen i madh me ujë të tejdukshëm. Në sipërfaqen e tij reflekton qielli blu me disa re të bardha që shëtisin ngadalë si zonja të rënda. Rreth e qark liqenit, pranë buzës së ujit, ngrihen drurët e pishës dhe të ahut, të cilat sikur mbijnë nga uji i liqenit. Ngadalë tek qëndrojmë ulur mbi një bregore, si pa kuptuar shohim se ka rënë mbrëmja dhe, midis degëve të drurëve vërshojnë ca rreze hëne që bëjnë përpjekje për të ardhur dhe për të bërë një banjë aty në liqenin e madh. Mbaj vesh jetën sesi gjallëron, ndjej murmuritjen bashkëbiseduese të flladeve të erërave, shushurimën e përrenjve të vegjël me ujë të freskët që rrjedhin ngadalë përmes rrënjëve të pemëve dhe pastaj kridhen në liqen në heshtje për t`i dhënë atij jetëgjatësinë.

Kemi shumë dëshirë të bëjmë një shëtitje me varkë në liqen, por roja i liqeneve na thotë se varka është mbytur diku në mesin e tij.

-E kanë mbytur një ditë ata nxënësit çamarrokë të shkollës së Lurës kur erdhën për ekskursion, - na thotë ai. Është një burrë i moshuar që punonte prej shumë vitesh aty te liqenet. Pastaj, ai shton:

- Mos jua bëni qejfin deri në fund fëmijëve, se përkëdhelen.

ATJE KU BËN BANJË E BUKURA E DHEUT

Natyra çelet, hapet si një gonxhe dhe atje tej shndrit liqeni i luleve, sinonimi më i goditur i bukurisë. Te ky liqen dhe tek vëllezërit e tij të mrekullueshëm, vijnë dhe shihen në pasqyrë çdo ditë - dielli dhe çdo natë - yjet. Me siguri që në këtë liqen bënë banjën e saj edhe e Bukura e Dheut. Mbi ujin e shndritshëm, vallëzojnë zambakë të kuq, të bardhë, të verdhë… trëndafila, gjethe në formë pjatancash të vogla e të mëdha në ngjyrë jeshile, kafe, rozë.. Një mozaik ngjyrash përkundet lehtë - lehtë mes dallgëzave të vogla lozonjare që krijon mbi liqen flladi i freskët mbrëmësor. Një heshtje e thellë, një qetësi që të grish e të mbështjellë me vellon e saj, të thërret dhe të ledhaton, të nanuris…Diku, aty ku fillon pylli i ahut, një burim me ujë të ftohtë. Freskojmë duart, krahët, qafën. Nëpër qiell, bashkë me Hënën, kanë çelur yjet e parë. Dy prej tyre bien mbi liqen, janë si një çift yjesh të porsa martuar, që si shtrat martesor këtë natë zgjodhën liqenin e luleve…

Shefi ynë na nxit që të shkojmë, se po bëhemi shumë vonë, por bukuria që kemi përpara vazhdon të na tundojë dhe nuk na lejon, na ka mbërthyer fort. Shkëputemi pa dëshirë, gati me dhembje nga ajo bukuri. Duke u larguar, dora më shkon si pa kuptuar mbi një zambak të bardhë. Por, tek po i gëzohem duke e përkëdhelur, ai, për habinë time, nis të vyshket me shpejtësi dhe të humbas jetën, ende pa u larguar nga shtrati i tij i lindjes. Ai zambak e kishte lindjen dhe jetën atje, tek ai liqeni përrallor ku lind bukuria.

Kthehemi të heshtur, dhe, në gjithë qenien tonë, në thellësi të shpirtit ruajmë përfytyrimin e asaj mrekullie mahnitëse që lamë pas. Makina jonë sepse duket nervoze, por pak më pas mendoj se nervoz është shoferi, i cili edhe ai si të gjithë ne është përfshirë në atë ndjenjë keqardhje që zgjon ndarja me bukurinë.. Por, ajo që po më befason më shumë, është se, edhe shefi ynë, i rreptë dhe i egër, tani qëndron i heshtur. Edhe ai ka rënë në ëndërrime.

SUKSESE ARBEN!

Në qytetin e Peshkopisë takojmë violinistin e ri dhe të talentuar Arben Spahiun, i cili studion në Austri. Një familje e thjeshtë dibrane, me tradita dhe zakone të mrekullueshme. Edhe djaloshi, një lastar i shëndetshëm i kësaj familje. Arbeni është në moshën midis fëmijërisë dhe rinisë. Ai kërkon po aq sa violinën, edhe topin. Ja, tani ai dëshiron të dalë e të luaj pakëz me top aty jashtë bashkë me shokët që e presin. Por ky djalosh me talent të rrallë, di të vendos harmoni midis lojës dhe violinës dhe, ndonëse nuk ndahet dot nga topi, mban me hatër violinën. Suksese Arben!

"IN VINO VERITAS"[1)]

Të ftuar nga shoku ynë dibran Kujtimi, shkojmë në shtëpinë e tij ku gjejmë ngrohtësinë dhe mikpritjen e sinqertë të familjes së tij. Njerëz dinjitoz, të thjeshtë dhe plot kulturë e, që dinë aq mirë si gjithë dibranët ta nderojnë dhe ta respektojnë mikun që u ka ardhur në shtëpi. Vera e kuqe trazohej në gota. Pimë dhe bisedojmë në atë atmosferë mikpritëse. Dhe aty, pas gotës së dytë të verës, shefi ynë i rreptë, na befason të gjithëve kur thotë me zë të mallëngjyer: "-Bëmë mirë, shumë mirë që vizituam Lurën dhe ata liqene. Eh, janë me të vërtetë të mahnitshëm! Me siguri, atje është vendlindja e të Bukurës së Dheut".

Tiranë, korrik 1985.

1). In vino veritas - latinisht: Në verë, e vërteta.

Dibranët i rikthehen traditës

Sapo makina fillon të zbresë poshtë ko drave të Llasenit, para shfaqet qyteti i Peshkopisë. Një pamje mahnitëse, e rrallë. Shtëpitë karakteristike dy katshe dhe pallate që shtrihen nga shëtitorja "Elez Isufi" dhe ashtu radhë-radhë në formë taracash ngjiten lart në Kamen, duke të dhënë një ndjesi të rrallë emocionale.Por jo vetëm kaq: ndërtesat shtrihen dhe në anën tjetër të shëtitores deri tek ish shkolla bujqësore sot shkolla pedagogjike.

Peshkopia, në mesjetë një qendër e madhe peshkopate, nga supozohet se dhe ka marrë edhe emrin, sot e vetmja qendër e madhe administrative në zonën lindore, nën juridiksionin e prefekturës së Dibrës, përfshirë edhe Bulqizën dhe Matin. Dikur një qendër e madhe arsimore, ku vetëm Internati i Kastriotit shuante etjen për dije, jo vetëm të dibranëve, por të gjithë Shqipërisë.

Sot në Peshkopi ka shkollë të përgjithshme, shkollë pedagogjike, një ndër më të vjetrat në lindje të vendit, shkollë ekonomike dhe shkollë për gjuhë të huaj, si dhe kurse për infermieri dhe mami. Peshkopia, që vite më parë njihej si një ndër qytetet më të pastra dhe me hapsira të bollshme të gjelbëra, sot nuk e ka humbur këtë emër. Shëtitorja, gjithmonë e pastër në të dyja anët veshur me blirët e shumtë, i jepnin hijeshi dikur këtij qyteti, ndërsa sot po mbyllen punimet e rikonstruksionit, që besoj se do di japin më shumë shkëlqim se dikur.



Dikur, era karakteristike e mollëve të markës "Starking' kundërmonte në të gjitha stinët. Sot vetëm blirët u falin banorëve aromën e veçantë që do ta kishin zili dhe qytete të tjera të mëdha. Në qytet ka dy buste; njëri Elez Isufi, udhëheqsi popullor i dibranëve në luftrat e përgjakshme anti serbe dhe tjetri Gjok Doci, hero i popullit, jetimi nga Lura që dha jetën në luftën nacional-çlirimtare. Nuk gjendet një bust i heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti, nuk gjendet në Peshkopi qoftë një objekt apo rrugë me emrin e tij. Ka buste të tij në Prishtinë dhe Shkup, në Romë dhe Paris, në Krujë dhe Tiranë, por në vendin e origjinës nuk gjendet një i tillë. E qyteti im, domosdo që ka nevojë për një bust të heroit tonë kombëtar, i cili t'ju tregojë vizitorëve se këtu e ka origjinën "mbrojtësi i krishtërimit".

Zërat e nxënësve që sapo kanë filluar vitin e ri shkollor, i japin jetë dhe gjallëri Peshkopisë. Gjallëri i japin edhe fermerët nga fshatrat e largëta që zbresin që në mëngjes në Peshkopi për të shitur ato pak prodhime blegtorale dhe bujqësore. Fermerët dibranë nuk janë larguar nga tradita. Pas viteve nëntëdhjetë, dora vandale shkatërroi ato pemtore të bukura që ishin ndërtuar vite me radhë me mund dhe sakrifica. Fermerët dibranë, në vend të tyre kanë filluar të ringrejnë të reja. Sot frutikultura zë një sipërfaqe të madhe në Dibër. Megjithëse struktura lë shumë për të dëshiruar, fermerët i shikon çdo ditë në pazarin e Peshkopisë. Tregu si tregu ama. Është mbushur plot me prodhime të huaja. Mollë e kumbull, pjeshkë e domate, bulmet e mish të ardhur nga jashtë, por fermerët dibranë nuk sprapsen përballë këtij realiteti. I tregtojnë prodhimet e tyre me çmime fare të ulta, të detyruar nga një konkurencë e pandershme. Isuf Shira, një blegtor nga Shumbati, ndryshe nga tradita ka ngritur fermën blegtorale. "Edhe pse një kilogram gjizë tregtohet me një cmim qesharak, kjo nuk do të thotë se ne dibranët të sprapsemi dhe të dështojmë" - thotë Isufi. Ai është optimist për të ardhmen. Po si Isufi, në Dibër ka mjaft të tjerë. Dikush kultivon jonxhën e dikush frutikulturën. Sherif Herra, një fermer tjetër shprehet: "Pemtoret e Dibrës vërtet u prishën, por në vend të tyre kemi vënë të rejat: kumbull, mollë, qershi, pjeshkë e hardhi. Jemi të bindur se do ta konkurojmë tregun e huaj sado që infrastruktura është e shkatërruar dhe nga shteti nuk kemi mbështetje". Në Shumbat, rrushi është prodhuar vazhdimisht, por që të ngrihej një bllok me vreshtari, këtë e bëri vetëm Petrit Mandri, një specialist i frutikulturës. Varietete të ndryshme ka në vreshtarinë e tij që më parë as që janë njohur në fshat. "Kam investuar shumë, thotë Petriti, por fundja kam arritur diçka".

Qyteti i Peshkopisë pret dhe përcjell njerëz të moshave të ndryshme. Vijnë çdo ditë njerëz. Dikush për tregti, e dikush rropatet dyerve të spitalit. Dikush për udhë, e dikush pret të takohet me të zgjedhurit. Në ndërtesën kryesore, ku është e grupuar e gjithë administrata dhe ku gjendet dhe prefektura, ka shumë njerëz. Prefekti Xhafer Seiti, jabanxhi siç i thonë fjalës, por shumë i përkushtuar për Dibrën, nuk largohet nga zyra pa takuar dhe të fundit që pret tek dera, një plak me qeleshe të bardhë nga Dardha.

Pasdite, qyteti është më i qetë. Largohen fermerët, por largohen dhe njerëzit e shumtë, dikush me probleme të zgjidhura e dikush ndoshta do të kthehet përsëri nesër. Pasdite vonë, këtu ka fare pak njerëz. Mbrëmja është e qetë në Peshkopi. Shëtitorja "Elez Isufi" është ajo që ka më shumë lëvizje. Deri vonë njerëzit bëjnë xhirot e mbrëmjes. Dikush dhe preferon kafenetë, dikush dhe ndonjë lojë bilardoje e të tjerë drejtohen drejt bibliotekës dhe internetit. Siç duket këtu i gjejnë ambientet që çlodhen.Peshkopia tashmë ka pallatin e kulturës, ndoshta më të mirin në shkallë vendi, paçka se u deshën vite për tu ndërtuar. Biblioteka e qytetit ka qenë ndër më të mirat, por prapë sot drejtoresha Marjana Bulku po përpiqet ta kthejë librin tek lexuesi. "Kemi bërë shumë, pasi lexuesit po shtohen, - shprehet Marjana, por përsëri me librin duhet të punohet". Në qytet ndodhet vetëm një librari. Sot aty ka shumë njerëz, fillon shkolla dhe nxënësit e mësuesit kërkojnë librin. Dibranët nuk e kanë braktisur asnjëherë librin. Falë librit dhe dijes sot vlerat intelektuale dibrane kanë dhënë kontributin e tyre në fusha të ndryshme.

Në Peshkopi ka mjekë dhe inxhinierë, oficerë dhe gjuhëtarë, diplomat dhe historianë, shkrimtarë dhe artistë, sportistë, paçka se shumica kanë emigruar. Këtu janë zhvilluar simpoziume dhe konferenca, aktivitete sportive, kulturore e artistike. Jo vetëm lokale, por edhe kombëtare dhe më gjerë. Këtu janë zhvilluar të gjitha sportet si: futbolli, volejbolli, mundja, alpinizmi. Këtu vite më parë filloi të ndërtohej dhe një pallat sporti. I bukur, të paktën nga projekti. Sportdashësit dibranë asnjëherë nuk patën fatin ta shikojnë këtë projekt bashkëkohor të përfunduar. Sot ka mbetur tamam si një bunker.

Peshkopia në mëngjes zgjohet herët. Të parët janë boritë e furgonëve që garojnë drejt kryeqytetit shqiptar si dhe punëtorët e pafjalë, që pastrojnë qytetin. Marrim rrugën e kthimit. Sapo ngjitemi kodrave të Llasenit, kthejmë edhe njëherë sytë për të parë qytetin e Peshkopisë. Asgjë nuk pipëtin. Dritat e shumta vezullojnë, dhe të japin idenë e një qyteti në rritje.

SHAQIR SKARRA

Botohen për herë të parë shënimet e ***Ismail Strazimirit***

Mbas ardhjes së Princ Vidit në Durrës



(Vijon nga numri i kaluar)

Princ Vidi, kishte ardhë në Durrës. Ministri i Posttelegrafave, Hasan Prishtina, i kishte çue nji letër Elez Jusufit, për të ba nji organizim komitash. Për të marrë programin e këtij organizimi e për t'u marrë vesht me Hasan Prishtinën, pata shkue në Durrës, aty kah fillimi i marsit të vitit 1915. Meqense ato dit ishte emnue Jusuf Bej Dibra prefekt i Dibrës, Hasan Beu s'më dha randësi. Jusuf Beu mue më kishte emnue drejtor të korrispondencës së prefekturës së Dibrës. Unë herë pas here ia kujtojsha Jusuf Beut çashtjen e Arif Hiqmetit, tue i thanë se po pregatitesh nji kryengritje. Nji ditë, në prani të drejtorit të financës së Dibrës, Hysen Beu, dhe sekretari i dytë i kryeministrit, Faik Beu, e hapa rishtas çështjen e Arif Hiqmetit, por ata m'u përgjigjën me mospërfillje, tue thanë se çështja s'kishte ndonji randësi dhe se kot bëheshin merak.

Më 26 prill 1915, u nisëm për në Peshkopi, unë, Prefekti, Jusuf Beu, drejtori i financës Hysen Beu dhe komandanti gjindarmërisë, Ali Beu. Ndërkohë, kish pas shkue në Maqellarë nënprefekti i Dibrës së vogël me disa prej parësive dhe, me nja njëmijë vetë, me qëllim që të përballojshin e të shtypin lëvizjen e Arif Hiqmetit, e cila tash kishte pas marrë nji ngjyrë serioze dhe të rrezikshme. Disa herë i ishin drejtue Durrsit dhe kishin kërkue armë e municion për të nisë nga operacioni. Por, meqenëse s'kishin marrë as përgjigje e municion, ishin shpërndamë, tue besue se në këtë çashtje luente rol gishti i Esat Pashës. Fuqia e Arif Hiqmetit u ndihmue prej qeverisë serbe me municion, me ushqim, bomba dhe ushtarë të mveshun me petka shqiptare, mandej marshon drejt Peshkopisë dhe arrin mbas disa përpjekjeve të bame, nji orë afër saj. Nënprefekti, z. Sadiku, që më parë s'i kishte dhanë as ma të voglën randësi çështjes së Arif Hiqmetit, tash ishte bamë gati me u arratisë. Sa sosëm, mblodhëm nji fuqi prej popullit dhe bashkë me fuqinë e gjindarmërisë i çuen para rebelave. Me këtë rast, e njoftuen Ministrin e Mbrendshëm Esat Pashën mbi ngjarjen, tue theksue randësinë e saj dhe i kërkuam se të na dërgonte sa më parë nji sasi municioni. Esati atë ditë kishte pas ardhë në Tiranë. Na u përgjigj, tue na porositi, që të çojshim kafshë në Tiranë, për të marrë municion dhe këtë përgjigje e dërgoi me besnikun e vet, Man Krujën, i cili, mbasi u takue tinës me Jusuf Beun, u kthye pa u vonue fare. Meqense plasi kryengritja e rebelëve në Tiranë, kafshët që çuem për të marrë municion u kthyen zbrazët dhe ne mbetëm me një pozitë kritike.

Në Dibër kryengritja, dita - ditës, po përhapesh e po merrte proporsione të rrezikshme, mbasi Arif Hiqmeti, po shpërndante shumë të holla. Edhe Elez Jusufit, të cilit ja maste mirë fuqinë, i propozonte me mijra napolona, po ai, në vend të napolonave i kërkonte fishekë e armë me qëllim që të sulmonte e të shtypte gjarpërin helmues. Me dekret mbretnuer, qe urdhnue Prefektura e Dibrës që t'organizohesh nji batalion gjoja për të shtyp kryengritjen e Beratit. Kjo qe me qëllim të mshefët t'Esat Toptanit, d.m.th. me rasë të nevojës por me e përdorue kundër Princ Vidit. Na këtë fuqi, mbasi e forcuem e përdorëm për me përballue fuqinë e Arif Hiqmetit. Asht e vërtetë se nuk mundëm me e shtypë, por të paktën nuk e lamë që të përparonte. Jusuf Beu përpiqesh ta shuej zjarrmin e kryengritjes, kurse Ali Beu tinëzisht mundohesh me e frye. Mbasi u dëbue Esat Pasha prej Durrsi, Osman Bali, me cilsinë e komandantit të fuqisë kombëtare në Tiranë u dërgoi nga nji letër Jusuf Beut e Dine Hoxhës. Me këtë letër, Osmani tue bamë fjalë për besnikërinë e afrimin që kishin me Esatin kërkonte ndihmë prej tyre. Veçanërisht, Jusuf Beut i lutesh që të shkonte në Tiranë për me e marrë në dorë frenin e qeverisë dhe komandën e fuqive të mbledhuna aty. Selim Lika, Halil Kaloshi, Ali Tahiri, Kurt Hoxha, Sheh Sehit Brezhdani, Reshit Sejfullahu, Sheh Hasani nga Tomini e disa të tjerë nga paria e Dibrës, dojshin ta ndrrojnë sjelljen apo situatën e tynë në favor t'Esatit, por s'guxuan me që Jusuf Beu ishte besnik i qeverisë dhe Elez Jusufi qëndronte serioz. Fuqija rebele e Arif Hiqmetit, herë mbas here, bante përpjekje me fuqitë tona. Nga ky shkak u paksuan dhe gati u mbaruen municionet tona. Si nga ky shkak, edhe nga droja se mos ndërhynte qeverija Serbe me fuqi ushtarake, kinse me e qetsue vendin, qemë hutue mjaft. Në dikasterin e Ministrisë së Punve të Mbrendshme kishte ardhë Arif Pasha. Për këtë cilsi prej Elbasanit i çonte një urdhër Jusuf Beut tue ba fjalë mbi fisin që kishim në mes e i thosh që të përpiqe dhe ma fort me e shue zjarrmin e kryengritjes në Dibër. Gjithashtu, e njoftonte se do t'i çonte, mbasi të shkonte në Durrës, edhe një rregullore veprimi, e cila s'u muer kurrë.

Fuqia e Arif Hiqmetit ishte prej ma se njëmijë vetash dhe komandohesh prej këtyre kryetarëve: Liman Lleshi, Halit Lleshi, prej Zogjaj të Dibrës, Tafë Kaziut prej katundit Selisht të Matit, Beqir Shiti prej Gjurasi, Sinan Krosi prej Bllace të Dibrës së madhe, Rahman Lika, Daut Mera, Mane Mera e Sadik Mura nga Luznia e Dibrës së vogël, Mexhit Toqi, Shahin Xhafa nga Kovashica, Destan Uka nga Sullukiqi katund në Dibrën e madhe, Haziz Kaca nga Dardha dhe Hasan Shabani nga Reçi i Dibrës së vogël. Arifi, si thash edhe ma naltë, derthte para të mëdha dhe me këtë mënyrë e shtonte influencën e vet. Imameve të atyne katunde që kishte pushtue i paguante nga 3 napolona dhe muezineve nga një napoleon rrogë në muej. Taktikë kjo, që e bënte me fitue për vete turmat injorante të popullit. Një ditë, Jusuf Beu, merr urdhën prej kryeministrit Turhan Pasha që ta merrte me vete municionin që kishte dhe të nisesh për Mat. Bashkë me Jusuf Beun shkuem në Mat. Aty erth letra me instruksionet e Kryeministrit. S'kishte as datë as nënshkrim. Përbahesh prej katër a pesë nenesh. Simbas këtyne instruksioneve porositeshim që të bashkoheshim me Ahmet Beun dhe të niseshim për në Qafë Murrizë, nji mal ndërmjet Tiranës dhe Matit, prej ku të hyjshim në marrëveshje me rebelet për ato kërkesa që mund të pranoheshin. Shtonte tue thanë edhe se n'asht se kjo korespondencë asht marrë vesht nga kryengritësit, atëherë të pushtoheshin majat dominuese të Krujes dhe të pritshin deri në një urdhër të dytë.

Në nji letër që i çonte Ahmet Beu Jusuf Beut porositesh që të merrte me vete një fuqi prej pesë a gjashtë qind vetash. Mirpo, batalioni i milicisë q'ishte afër njimijë vetash ishte lanë përballë rebelëve të Arif Hiqmetit, po të merresh kjo fuqi, do t'i nepesh shkak që të përhapeshin rebelet në të tanë qarkun e Dibrës. Dhe atëherë Arif Hiqmeti do të përmblidhte nji fuqi aq të tmershme sa as populli i Matit as trimat e Shqipnisë së mesme nuk do të mundeshin me i qëndrue. Megjithqë, Jusuf Beu nuk e dinte këtë të vërtetë të idhët, nuk kishte marrë me vete nji fuqi sa duhej dhe i kishte porositë dhe lutë parësinë e Dibrës që ta mbajshin statu-quo-në deri sa të kthehesh ai nga Mati, ku thoshte se s'kishte për të ndejtë ma tepër se dy ditë. Gjithashtu, me këtë qëllim bani njifarë armëpushimi për katër pesë dit me rebelët

Ç'PAMË NË DURRËS

Pozita e Jusuf Beut qe shumë e vështirë, sepse jo vetëm nuk kishte çue municion prej Durrsi, por dhe gjandarët kishin për të marrë nga tri e katër rroga, mos pagimi i të cilave do t'i pezmatonte ata prandaj vendosi për me shkue në Durrës për të ekspozue verbalisht situatën e Dibrës. Në ditët e para të qershorit 1914 sosëm në Durrës, kryeministri Turhan Pasha i tërhoqi vërejtjen Jusuf Beut, pse kishte ardhë në Durrës pa leje. Pashaj i Turqisë së vjetër edhe në ato kohë kritike kërkonte të respektonte rregullat…Mbas nji bisedimi që u zhvillue në mes të Jusuf Beut me Aqif Pashën me organizatorin e gjandarmërisë Kolonel Tomsonin, u vendos të paguhen rrogat e gjandarëve të Dibrës, ti nepen Jusuf Beut nja njiqind arka me municion dhe nji top që ndodhesh n'Elbasan e të çohesh në Dibër. Këto masa qenë fare të arsyeshme se Arif Hiqmeti propagandonte tue thanë se nuk e lejon Evropa qeverinë e Durrsit që të çojë në Dibër municion e t'ua paguante gjandarëve rrogat?Po të paguheshin rrogat e po të çohesh në Dibër municion do të përgënjeshtrohej propaganda e Arif Hiqmetit dhe me këtë mënyrë do t'i shtohej prestigji e fuqia qeverisë. Në një rast të tillë, do të ishte lehtë me mbledhë në Dibër nji fuqi të madhe tue kalue nëpërmes t'Elbasanit të zihej vend në Qafë Krabë, prej ku t'i kërcënohesh Tiranës së rebelueme. Ndoshta nuk do t'ishte e mundun që të shtypeshe plotsisht kryengritja, por të paktën mund të shtërngoheshin rebelët për të marrë vesh me qeverinë. Por mjerisht ndryshoi puna dhe vendimi nuk u zbatue për këto shkaqe: Atë ditë mësyen Durrsin rebelët dhe ra dëshmor i vlefshmi dhe i çmueshmi kolonel Tomsoni, gja e cila e paralizoi punën. Veç kësaj, të nesërmen Mark kapidani me qëllim që t'i shtypi rebelët u nis drejt Rrashbullit me nga njimijë e pesëqind mirditas dhe nja treqind kosovar. Kjo fuqi e nisun prej Durrsi, me aq madhështi, ndeshi në pritat e rebelëve që kishin zanë vend në Shkozet ndërmjet urës së Dajlanit e Rashbullit dhe u mund e u dërmue aq keq sa nuk gjendet fjalë për me e theksue plotsisht. Përpos kosovarëve që e mbajtën veten, të tjerët u tmerruen prej rebelëve të Shqipnisë së mesme dhe ikën të shkatruem fare keq, me një mënyrë të turpshme. I mbrami e shkilte të parin dhe nuk vërente veçse t'a shpëtoi veten. Ishin zhyt nëpër moçalet dhe ishin ndragë këmbë e krye me baltë. Populli i Durrsit megjithqë i pezmatuem nga disfata e fuqisë qeveritare, kur i pa mirditasit të kthehen të ndragun fytyrash me baltë nuk mundi me e mbajtë gazin dhe i vuni në lojë. Vetë Marka kapidani që komandonte mirditasit iku tue e ngamë kalin me të katra dhe s'patën guximin me i tërheqë jashtë rrethit të rrezikut as edhe të plagosunit. Kjo disfatë i turbulloi tepër autoritetet qeveritare si dhe popullin. Ndërtesa e madhe ministriale u kthye në spital dhe ministrat mbledhjet e veta zunë me i bamë ndër shtëpiat e tyre tue shkue herë ke njani herë ke tjetri, plotsisht si ngjante dikur netëve të dimnit në mes të shokëve që bajshin mbledhje shoqnore. Jusuf Beu si me gojë ashtu dhe me shkrim kërkonte të zbatohet vendimi i dhanun, po kush ja varte veshin se…Kjo mospërfillje e dëshpëronte Jusuf Beun. Veç kësaj qeveria qëndrore herë pas here bante gabime tjera dhe kësisoj ia cënonte sedrën e tij personale e zyrtare. Përshembull, ato ditë kishte ardhur në Durrës Islam Spahiu prej Lume. Megjithqë Jusuf Beu si prefekt i Dibrës ishte nëpunsi përgjegjës dhe i nënprefekturës së Lumës dhe njoftues i gjendjes së saj, këto as ja muerën mendimin, por tue shpresue se Islam Spahia do t'u çonte fuqi nga Luma, e çojnë n'adiencë ke mbreti dhe e davarisin me pesëdhjet napolona. Por mbi të gjitha Jusuf Beun e mbajshin si vrejtje, si njeri të dyshimtë. Nji ditë, në vend që të thirrshin nji tjetër, gabimisht e sikur me u thirr nji prej turmës së popullit, u ftue Jusuf Beu në gjyqin ushtarak dhe e muerën në pyetje si të pandehun për nji çashtje që s'kishte të bajë fare me të. Çrregjim i çuditshëm që ishte! Jusuf Beun tue cmue fare mirë gjëndjen delikate të Dibrës, të krijueme prej Arif Hiqmetit, si me gojë ashtu edhe me shkrim, i propozonte qeverisë që të nisesh vetë sa më parë ose të cohesh nji tjetër për Dibër. E pra, mbasi Dibra kishte mbetë në një situatë të rrezikshme, sa më shpejt duhej dërgue Jusuf Beu në krye të detyrës që pat, ose me qenë se bajshin dyshime mbi të, duhej të çohej nji tjetër Prefekt e të mos lihej vendi zbrazët e dibranët pa krye e si jetim të habitun. Për fat të keq, s'u ba as njena, as edhe tjetra. Vetëm u banë gabime trashanike, si përshembull, në vend që të çohej Jusuf Beu, u çuen n'audiencë njerëz si Islam Spahiu. Kur po niseshim nga Durrsi për në Dibër i thamë Mehdi Frashërit Prefekt dhe z Midhat Frashërit ministër: "Kot na mbajtët këtu kaq kohë. Tashti po kthehemi prapë pa municion, këto ngurime e dyshime s'janë të mira.

(Vijon numrin e ardhshëm)

© Shënimet e Ismail Strazimirit botohen me lejen e Drita Agollit (Strazimirit) dhe Zeqi Agollit.

Elez Sadik Koçi, një jetë në shërbim të gjuhës shqipe dhe atdheut

Elez Koçi u lind në vitin 1856, në fshatin Ostren i Madh. Prindërit e tij janë marrë kryesisht me bujqësi dhe blektori. Burrat ishin edhe murator dhe e ushtronin këtë profesion brenda dhe jashtë vendit. Në moshën 12-vjeçare, babai i tij e dërgoi në shkollën fillore në qytetin e Dibrës së Madhe. Mësimet në shkollë zhvilloheshin në gjuhën turke, por Elez Koçi gjeti kohë të mësonte ilegalisht gjuhën shqipe.

Në shkollë Elezi shkëlqente në mësime dhe në sjellje. Ai u shqua për zgjuarsi. Babai i tij vendosi ta çonte në shkollë të mesme fetare për hoxhë në Manastir. Atje, mësoi të flasë dhe të shkruajë edhe persisht dhe maqedonisht. Nën ndikimin eë qarqeve patriotike që vepronin në atë kohë, ai u formua dhe u brumos me idetë atdhetare të shqiptarizmit. Jemi në vitet e para të formimit të Lidhjes Kombëtare të Prizrenit dhe, ndërgjegjja kombëtare ishte rritur në një nivel më të lartë. Idetw, që fitoi Elezi nw Manastir, i shërbyen gjatë gjithë jetës pwr çështjen kombëtare. Atdheu, pwr tw, ishte i shenjtë.

Në vitin 1876, Elezi mbaroi shkollën e mesme. Ai nuk e pranoi vendimin e Myftiut tw Dibrës së Madhe pwr tw punuar si Hoxhw. Ai nuk pranoi të kryente një detyrë të tillë, dhe të vihej në shërbim të Perandorisë Osmane. "Nuk ka fe pa atdhe", thoshte ai, dhe atdheun e kuptonte pa sundimin e Turqisë. Ai propagandonte se ne jemi shqiptarë, ne duhet të mësojmë gjuhën tonë, të kemi shkollat tona dhe duhet të hapim shkolla shqipe në fshatra. Mbasi u kthye në vendlindje, hapi një dyqan ku tregtonte vogëlsira dhe sende ushqimore. Ky dyqan u kthye në qendër tw pwrhapjes sw ideve antiturke. "Ne jemi shqiptarë, ne nuk duhet t'i paguajmë taksa Turqisë, nuk duhet të shkojmë ushtarë e të vritemi për interesat e Turqisë", u thoshte shpesh bashkwfshatarwve tw tij. "Ne jemi komb më vete dhe kombi shqiptar ka historinë e tij të lavdishme, ai duhet të ketë shtetin e tij. Ne kemi flamurin tonë kombëtar. Gjuhë zyrtare duhet të jetë gjuha shqipe dhe nëpunësit të jenë shqiptarë. Këto të drejta dhe liri që na i ka mohuar pushtuesi osman, ne do t'i fitojmë kur të fitojmë pavarësinë, të shpëtojmë njëherë e përgjithmonë nga shtypja dhe shfrytëzimi turk". Elezi në biseda me të afërmit e tij, kritikonte mbajtjen e flamurit turk nga krushqit kur shkojnë të marrin nusen. Ata duhet të mbajnë flamurin shqiptar, shqiponjën me dy krena.

Elez Koçi ka luftonte me armë në dorë kundër pushtuesve turq dhe shovinistëve serb gjatë viteve 1909-1912. Në fund të vitit 1909, pikërisht mbas kthimit të patriotit Hoxhë Muglica prej Kongresit të Manastirit u bë një mbledhje në Fushë të Klenjës. Hoxhë Muglica u shpejegoi popullit tw Gollobordws vendimet e marra në Kongresin e Manastirit për Gjuhën Shqipe. U foli mbi rëndësinë e mësimit të gjuhës shqipe, mbi hapjen e shkollave dhe për rëndësinë e hapjes së shkollës normale të Elbasanit. Ai tha se duhet kërkuar prej çdo dere të shtëpive të parësisë së Gollobordës, të dërgojmë nga një djalë në shkollë në Elbasan. Elez Koçi u tha të pranishmëve se ka ardhur koha që çdo fshat të hapë shkollën e tij në gjuhën shqipe.

Autoritetet turke të Dibrës sapo mësuan mbi mbledhjen, dërguan në Gollobordë një fuqi ushtarake nën komandën e një kapiteni. Kjo fuqi u bashkua me fuqitë turke të krahinës së Klenjës dhe kwrkonin tw arrestonin Hoxhë Muglicën dhe bashkëpunëtorët e tij. Ndwrsa popullin e kërcënuan. Turqit synonin të përçanin e shkëputnin marrëdhëniet mes atdhetarëve gollobordas të rrezikshëm për shtetin turk Avdi Hoxha Sallai, Qazim Duka, Haziz Lila e të tjerë.

Grupi i atdhetarëve, duke i parashikuar torturat që do t'u bëheshin burrave që kishin marrë pjesë në mbledhjen e Fushës së Klenjës, rrokën armët dhe zunë vendet me strategjike afër fshatit Zepisht nga do të kalonte ushtria turke. Sul Hoxha me fuqinë e tij zuri Grykën e Borovës.

Rakip Hoxha me vëllezër u vendos në rrugët e Klenjës. Vetë Hoxhë Muglica me nipat e kushërinjtë e tij zuri Qafën e Destiles. Kurt Balla, Avdi hoxhë Sallaku, Shaqir Sallaku, Ferat Hysa, Tafë Hysa, Muharrem Lika e disa të tjerë zunë Grykën e Zepishtit, në Majë të Brashnikut. Elez Koçi, Qazim Duka, Bajram Koçi me disa fshatarë të Ostrenit të Madh, bllokuan Qafën e Testikamenit, te Kulla, mbi Dragalicë[1)].

Sul Lila me nipat dhe fiset e tij u vendos në Kreshtat e Borovës. Një orë përpara agimit të ditës, fuqia qeveritare u ndesh me ata të Sul Hoxhës me shokë. Këta luftuan disa orë me trimëri. Nga e gjithë krahina e Gollobordës, njerëzit që kishin dëgjuar krismat e pushkëve u derdhën në ndihmë dhe, mbas një luftimi prej katër orësh, ushtria turke u largua e shpartalluar keq. Autoritetet turke nuk mund ta harronin këtë disfatë fatale.

Ata derdhën në Gollobordë zbuluesit e tyre, për të zbuluar e kapur organizatorët e mbledhjes dhe të sulmeve kundër forcave turke. Mbasi mundën të siguronin informacione të plota, mbas disa ditësh dërguan një fuqi të re të armatosur nga Dibra e Madhe, për t'i zënë të gjallë ose të vdekur rebelët. Kjo fuqi ishte e armatosur me topa e mitraloza, por edhe kjo pësoi fatin e të parës, u shpartalluar edhe më keq. Kjo fitore mbi pushtuesit turq rriti më tej ndërgjegjen kombëtare. Populli i kësaj krahine filloi nga lethagjia shekullore dhe u krijua mendimi i mëtejshëm se s'kishin asnjë lidhje me qeverinë turke që e kishte mbajtur më shumë se 400 vjet në robëri Shqipërinë [2)].

Në vitin 1911, autoritete turke, për të ushtruar kontroll më të rreptë në krahinën e Gollobordës, vendoswn krijimin e një krahinarie -Mydyllëku, në fshatin Ostren i Madh. Krerët atdhetarw të kësaj krahine e parapanë se me hapjen e krahinarisë do të pengohej veprimtaria e tyre kombëtare. Ata propaganduan me të madhe dhe e bindën popullin se hapja e zyrës së krahinarisë në Ostren të Madh ishte në dëm të interesave të banorëve të Gollobordës. Një ditë, krejt papritur, një numër i konsiderueshëm burrash të armatosur, të nxitur nga krerët atdhetarw të krahinës, Elez Koçi, Hoxhë Muglica, Haziz Lila, Avdi Hoxhë Sallaku e të tjerë sulmuan zyrën e krahinarit të sapo krijuar. Mbas një përpjekje të vogël, e pushtuan zyrën, i morën armët krahinarit dhe xhandarëve dhe, mbasi i lidhën, i nisën për në qytet të Dibrës së Madhe. Ata dogjën dhe grisën dokumentet e aktet e gjetura në zyrë. Gjesti i ndodhur në Ostren të Madh, i zemëroi pa masë autoritetet e Dibrës së Madhe të pushtetit turk. Qeveria turke menjëherë vendosi dërgimin e një ushtrie në këtë krahine, nën komandën e një oficeri të lartë për t'u dhënë ndëshkimin hakmarrës shkaktarëve dhe për të çuar në vend nderin dhe autoritetin e shtetit turk. Organet qeveritare turke kishin siguruar informacione të plota për organizatorët e këtyre veprimeve. Ata arritën me anën e spiunëve të fusin në dorë disa nga organizatorët e këtij akti. Njëri nga këto ishte edhe Elez Koçi, të cilin e dënuan me tre vjet burgim në Dibër të Madhe. Organet turke e akuzuan Elez Koçin se ka tentuar të vrasë edhe Bimbashin turk. Koha e burgimit e aftësoi, e formoi dhe e kaliti më tepër si kundërshtar të regjimit turk Elez Koçin. Ngjarjet e zhvilluara gjatë kohës e sollën që Elez Koçi të lirohet përpara kohe nga burgu.

Ndërgjegja kombëtare kishte arritur kulmin. Në këtë periudhë mësimit të gjuhës shqipe dhe përdorimit të shkronjave shqipe u jepej rëndësi e madhe. Abetaret që vinin nga shoqëritë e Stambollit, Sofjes, Bukureshtit e tjera i mbanin njerëzit nëpër xhepa. Ata i sillnin në fshatrat e Gollobordës dhe krahina të tjera të Dibrës Seit Najdeni (Hoxhë Voka), Hoxhë Muglica, Elez Koçi e disa të tjerë.

Bashkëkohësit e tij Elez Koçin e kanë njohur burrë të pashëm me trup të gjatë. Atij i kishte hije fjala kur fliste në mexhlis (mbledhje). Ai dinte të bisedonte me njerëz të shtresave të ndryshme. Ishte njeri i arsimuar, me horizont, bujar, bestar, me shpirt të madh, trim dhe atdhetar.

"Fjala e tij zinte vend kur fliste. Ai kishte zë të ëmbël dhe të bënte për vete. Dinte të shpjegonte ngjarje të kohës dhe parashikonte zhvillimin e tyre për të ardhmen". [3)]

Xhelal Roçi

(Vijon numrin e ardhshëm)

---

1) Tregime gojore, kujtime nga Hysen Guri (Tola), Lagjja Guri dhe Adem Ahmet Muça nga Ostreni i Mdh.

2) MHRr., Dibër, Dosja 118, f. 2-3. Haki Stërmilli: Dorëshkrim "Dibra në prag të historisë". Kujtime: Nga pjesëtarët e familjes dhe Adem Muça nga fshati Ostren.

3)Kujtime nga bashkëfshatari i tij Yzeir Kurti, i cili banonte me shtëpi afër tij në fshatin Ostren i Madh.

SHKURT

"SOPATA" PO ZHDUK PYJET

Masive të tëra pyjesh po shkatërrohen nga "sopata". Megjithë masat penalizuese të marra nga policia pyjore, përsëri ky fenomen mbetet shqetesues për njerëzit që kanë marrë përsipër mbrojtjen e pyjeve nga prerjet pa kriter.



Tregtarët, me leje e pa leje për shfrytëzimin e lëndës drusore, po bëjnë po vazhdojnë prerjen e drurëve në pyje kundër ligjeve. Çdo ditë po ngarkojnë makina të tonazhit të rëndë me dru zjarri dhe lëndë drusore në pyjet, të cilat janë një pasuri e madhe me vlera ekologjike dhe ekonomike. Kërkesa për dru vjen nga qytetarët, të cilët çdo ditë e më tepër po përdorin si alternativë për ngrohje drutë e zjarrit, pasi ngrohja me energji elektrike nuk është e mundur, sidomos pas rritjes së çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë.

Me këto ritme të prerjes së lëndës drusore do të vijë dita që masive të tëra me pyje të zhduken nga harta. Këtë fakt e pohon edhe shefi i sektorit të policisë së shërbimit pyjor, Zyber Kaba. Ai thekson se policia pyjore ka sekuestruar gjatë kësaj kohe mbi 10 ifa me dru zjarri dhe 1 ife me lëndë drusore, si dhe ka vene mbi 53 gjoba me vlefte 7.408 mijë lekë të reja. Por ky problem vazhdon të mbetet shqetësues sidomos në Kasni dhe në Lurë, megjithëse janë pushuar nga puna edhe disa punonjës të policisë pyjore.

SHKOLLAT, FONDI PËR RIKONSTRUKSION 212 MILIONË LEKË

Edhe në rrethin e Dibrës, në të gjitha shkollat 9-vjeçare e të mesme, nisi viti i ri shkollor 2006-2007. Gjendja e amortizuar e shumë shkollave si dhe mungesa e mësuesve të kualifikuar, janë dy nga problemet më të mprehta me të cilat do të përballet sistemi arsimore këtë vit. Nxënësit, në një pjesë të mirë shkollash do të përballen me kushte të vështira në mjediset ku do të zhvillohet mësimi. Fondi në dispozicion të Drejtorisë Arsimore këtë vit ka qënë mbi 212 milionë lekë, por pësëri mbetet shumë për të bërë në rikonstruksionine mjaft shkollave në Dibër.

ENERGJIA, PO PUNOHET PËR NJË DIMËR ME DRITA

Rrethi i Dibrës ka qenë shumë problematik, për sa i përket furnizimit me energji elektrike gjatë muajve të ftohtë të dimrit. Kjo për shkak të terrenit të thyer malorë, amortizimin e rrjetit dhe defekteve të shpeshta të krijuar në rrjetin shpërndarës. Ndërmarrja e shpërndarjes ka nisur që në muajin prill remontet e shumta dhe ndërhyrjet në rrjet nëpërmjet investimeve për të krijuar kushte optimale për të patur një furnizim pa ndërprerje gjatë muajve të dimrit. Drejtori rajonal I KESH-it, Sulejman Lami, thotë se ndërprerje do të ketë vetëm në raste të defekteve të pariparushme, apo ndonjë remonti emergjent, por nuk do të ketë kufizime të energjise elektrike gjatë dimrit". Sipas tij, në Dibër gjatë muajve të verës është janë bërë remonte të shumta në rrjetin e shpërndarjes. Zvogëlimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës dhe rritja e arkëtimeve do të krijojnë kushte të favorshme për të patur energji elektrike pa ndërprerje.

GJENDJET CIVILE, JO MË ME RREGJISTËR TË PËRKOHSHËM

Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Civile në Ministrinë e Brendshme, z. Hysen Osmani, gjatë një takimi me punonjësit e gjendjeve civile dhe kryetarët e bashkive dhe komunave të Prefekturës së Qarkut të Dibrës, theksoi nevojën e eliminimit të rregjistrit të përkohshëm të gjendjeve civile. Ai theksoi se ky vendim i qeverisë shqiptare, është në zbatim të prioriteteve që ka qeveria në kuadër të marrëveshjes së Stabilizim –Asocimit, për të realizuar zgjedhje korrekte dhe të ndershme". Vendimi, sipas z. Osmani, ngarkon të zgjedhurit vendor të realizojnë këtë proces në mënyrë transparente e ligjore. Ai theksoi gjithashtu, se qeveria shqiptare e konsideron shumë të rëndësishëm këtë proces, për të ditur vendbanimin e çdo qytetari të Republikës së Shqipërisë, jo vetëm për të patur zgjedhje të lira e korrekte, por edhe sepse ne jemi vendi i vetëm në Europë që nuk e kemi të saktë numrin e popullsisë, vendbanimin e qytetarëve, dhe pronën e tyre.

/ M.Lala


KORRIGJIM

Me kërkesën e Prof. Dr. Nuri Abdiut, titulli i shkrimit të akademikut Bedri Dedja, botuar në gazetën "Rruga e Arbërit", nr.2, Qershor 2006, është shkruar gabimisht: "Vepër specifike, origjinale, me rëndësi historike kombëtare", duhet lexuar: "**Vepër specifike origjinale, mbi një temë me rëndësi historike kombëtare**".

REDAKSIA

Dy dibranët që sollën në shqip "Paris 1919"

Fatmir Xharri dhe Myrteza Shini kanë përkthyer librin e autores amerikane Margaret Macmillan, e cila shkruan për gjashtë muajt që ndryshuan botën.



Pas një sërë botimesh të ndryshme me autor dibranë, më së fundi dy djem të rinj, dy përkthyes të talentuar, na japin në duar një vepër vërtet dinjitoze. Fatmir Xharri dhe Myrteza Shini, pas një kariere të gjatë në diplomaci, tani shfaqen edhe në fushën e përkthimeve. Dhe jo me një vepër dosido. Por me "Paris 1919", i cili pasqyron gjithë skenat dhe prapaskenat e Konferencës së Paqes.

Të dy bashkë me një përkthim dinjitoz, bënë të mundur që dhe autorja e sukseshme e letërsisë historike politike, Margaret Macmillan, të flasë shqip. Libri ka kohë që është botuar në shumë gjuhë të botës, por në Shqipëri u botua këtë vit nga shtëpia botuese "Plejad", e cila konfirmon suksesin e librit në treg. Libëri është voluminoz, por nuk janë fletët e shumta ato që i japin rëndësi kësaj vepre. Janë pikërisht, materialet që libri mbart në brendësi, janë hartat e shumta, fotografitë e personaliteteve që u mblodhën në Paris në vitin 1919, në Konferencën e Paqës. Pikërisht, këtë temë trajton autorja ndaj e ka titulluar "Paris 1919 - Gjashtë muaj që ndryshuan botën".

Duke parë rëndësinë e këtij libri, gazeta më e madhe në SHBA "NEW YORK TIMES e ka klasifikuar si libër Bestseller, ne nuk na mbetet veçse të urojmë përkthyesit dibranë, të cilët bënë të mundur që këtë libër ta afrojnë pranë lexuesit shqiptar.

Robert Reçi

Peshkopia, oazi i qetë në verilindje

(Vijon nga faqja 1)

Popullsia e Peshkopisë ka ndryshuar shumë gjatë periudhës paskomuniste. Rreth 70 përqind e qytetarëve janë të ardhur të rinj, shume nga zonat e thella bujqësore. Por ata kanë mësuar dhe janë imponuar me mënyrën e jetesës në qytet.

Qyteti duket sikur është i gjithë në ndërtim. Bëhet punë publike për të riparuar kanalet e për të asfaltuar rrugët. Rrugët janë dëmtuar shumë ose nuk janë mirëmbajtur për një kohë të gjatë. Rruga që të çon në Kukës ose në Kalanë e Dodës është shumë e vështirë. Rruga e Rinise, siç quhej kur u ndërtua me punë vullnetare nga rinia gjatë regjimit komunist, nuk përdoret më, sepse është shumë e dëmtuar. Rregullimi i rrugëve është prioritet, por mungesa e fondeve dhe e dëshirës së qeverisë qëndrore ka bërë që të ketë vetëm dy persona, që riparojnë e mirëmbajnë 90 kilometra.

Shumë banorë të Peshkopisë janë larguar, shpesh duke shkuar në Kosovë. Resmi Alku është baba i tre fëmijëve dhe punon si murator. Ai shkon shpesh në Kosovë, ku mund të paguhet 20-25 euro në ditë, por shton edhe se të gjesh punë këtë vit është bërë shumë e vështirë. Murtoret nga Peshkopia, ose Dibra, njihen si profesionistë e kërkohen kudo.


T.T. BACK PAGE

Peshkopi, the calm oasis in the northeast

Via Vienna to the whole world

Austrian

Në qytet nuk ka fare industri. Kjo është arsyeja që shumë prej tyre janë larguar në drejtim të kryeqytetit, Tiranë ose qytete me të mëdhenj se i tyre, ose në Kosovë e Maqedoni për të gjetur punë. Rreth 476 biznese private janë kafene e resotrante ose dyqane të vegjël të shitjes me pakicë. Evazioni fiskal, natyrisht që është i lartë, pasi ky është numri i atyre bizneseve që janë regjistruar. Çmimet nuk ndryshojnë shumë nga qytetet e tjerë. Ato furnizohen nga biznesmenët e shumicës në kryeqytet.

Nëse ata prodhojnë diçka, le të themi mollë, për të cilat janë të njohur, për ta nuk ka treg, transport ose mjete të tjera që të mund të mbajnë veten.

Besohet se rreth 3,000 persona nga rrethi kanë shkuar në imigracion, të cilët sjellin para për të mbajtur familjet e tyre.

Zona njihet edhe për llixhat që shfrytëzohen që prej vitit 1957, kur u krijuan. Atje mund të shohësh gjithnjë e më shumë ndërtues. Tani llixhat shfrytëzohen nga biznese private. Kanë një kapacitet për 1,000 persona dhe çmimi është 16 000 lekë për dy javë. Shumë njerëz nga Kosova e Maqedonia e frekuentojnë shpesh. Ka filluar puna për riparimin e rrugës prej dy kilometra që lidhet me Peshkopinë.

L.Semini



INTERNET +

me qendër në Laprakë, Rruga e Durrësit, pallatet "Havai", poshtë klinikës mjeksore "GLOB"

Shërbejmë: Servis kompjuterash,aksesor të ndryshëm, shitje kompjuterash, printera, fotokopje, skanera, tavolina.Qendër e madhe interneti si dhe shpërndarje në zyra dhe familje në distancë të afërt nga qendra jonë.

Çmimet tona janë më të lira në treg.

Mjafton të vini njëherë dhe do të mbeteni klientët tanë të përhershëm.

Ju mirëpresim në çdo orë të ditës.

Telefon: 0692530161.

QENDRA JARCAH

XHARCAH CENTER



Adresa:
Rr. Durrësit, Pall. HAWAI, Laprakë, Tiranë.

Organizon kurse të aftësimit profesional:

- ✓ Gjuhë të huaja: anglisht, frengjisht, italisht, greqisht, gjermanisht etj.
- ✓ Kurse kompjuteri, Word, Window, Excel, Corel Draw.
- ✓ Kurse për sekretare, typing, operatore zyre, daktilografiste, arshiviste etj.
- ✓ Staf mjaft i kualifikuar mësimdhënës me metoda dhe mjete audio-vizive bashkëkohore.

FTESË

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për çdo lloj bashkëpunimi. Të Interesuarit mund të sjellin opinionet e tyre për çeshtje e probleme të ndryshme që shqetësojnë Dibrën e dibranët. Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist.

Redaksia kujton bashkëpunëtorët se dorëshkrimet janë të pakthyeshme dhe jo çdo shkrim mund të botohet.

Tel.068 31 19 232.
Tel: (04) 357 179.
Email: lid_gazeta@yahoo.com

KONKURS

Në kuadër të botimit të kalendarit "Dibra 2007", ftojmë të interesuarit, fotografë dhe amatorë, të sjellin fotografitë e tyre për kalendarin. Fotografitë do të përzgjidhen nga stafi i botimit të kalendarit. Fotot që do të botohen do të shpërblehen.
Fotot duhet të jenë të shoqëruara me një shënim shpjegues, por jo më të gjatë se 30 karaktere. Fotografitë duhet të jenë dixhitale ose të stampuara në format kartoline të shoqëruara me negativin.
Afati i fundit i pranimit të fotografive është data 10 tetor 2006.
Për më shumë informacion telefononi në numrin: (04) 233 283 ose shkruani në email: mbujar@yahoo.com

*Grafika: **Studio "m&b"**. Tel: (04) **233 283**. Shtypur në shtypshkronjën "**Dita 2000**". Tel: (04) **273 745***